

**Pritje e Presidentit Bujar Nishani**

**me rastin e “Tetorit gjerman”**

**31 tetor 2016**

**Tiranë, Pallati i Brigadave**

**Fjala përshëndetëse**

**Amabsadore Susanne Schütz**

**Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë**

Shumë i nderuar z. President,

shumë e nderuar znj. Nishani,

shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

të dashur miq të bashkëpunimit gjermano-shqiptar,

fillimisht dëshiroj t'ju falënderoj përzemërsisht për ftesën në Tetorin Gjerman të këtij viti në institucionin tuaj, i cili është shndërruar tanimë në një traditë shumë të bukur.

Ju falënderoj gjithashtu për fjalët miqësore për bashkëpunimin e ngushtë e shumëvjeçar mes Gjermanisë dhe Shqipërisë.

Kolegët e mi të Ambasadës Gjermane, bashkëpunëtorët e institucioneve gjermane aktive në Shqipëri në kuadër të projekteve të bashkëpunimit gjermano-shqiptar, si dhe të gjithë të pranishmit i vlerësojnë mjaft ftesën dhe fjalët tuaja.

Në mënyrë të veçantë gëzohemi për vlerësimin, që motrat Maria Gratias Ruf und Maria Bernadette Ebenhoch nga Fushe Arrez dhe motrat Relindis dhe Angela nga Delvina marrin sot prej jush duke u dekoruar për angazhimin e tyre shumëvjeçar në mëbështetje të qytetarëve në nevojë sociale në komnat, ku ato veprojnë. Ky është

një nderim, të cilin e konsiderojmë edhe si vlerësim të veçantë për angazhimin gjerman në fushën sociale dhe atë të ndihmës humanitare, angazhim ky që praktikohet tanimë prej shumë vitesh dhe njerëzish si në Shqipëri ashtu edhe në Gjermani në të mirë të marrëdhënieve gjermano-shqiptare.

Sikurse e përmendët edhe ju, këto marrëdhënie në 30 vitet e fundit kanë njohur një zhvillim të shkëlqyer. Për mua është kënaqësi e veçantë, që marrëdhëniet politike janë intensifikuar ndjeshëm me procesin e Ballkanit Perëndimor iniciuar prej Gjermanisë dhe me dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Vizitat e Kzl. Federale, e Ministrit të Jashtëm Federal dhe shumë politikanëve të tjerë kanë dëshmuar që Shqipëria ka shënuar ndërkohë një progres të rëndësishëm në kuadrin e reformave në rrugën e saj të përafrimit me BE-në, para së gjithash në atë të sektorit të drejtësisë, për të cilën miratimi i njëzëshëm i ndryshimeve të kushtetutës në korrik të këtij viti ishte kapërcimi i një pengese të madhe. Dhe tani është çështja e miratimit të bazave të mëtejshme ligjore dhe sigurisht edhe implementimi i tyre, Unë jam besimplotë se edhe Ju, që jeni shprehur në mënyrë të përsëritur në mbështetje të procesit të përafrimit me BE-në, do t'i mbështesni këta hapa të rëndësishëm brenda mundësive tuaja.!

Edhe në kuadër të bashkëpunimit tonë dypalësh në sektorin e ekonomisë vitin e shkuar kemi bërë bashkarisht shumë hapa përpara. Me ndihmën e GIZ dhe KfW-së është rënë dakord për shumë projekte të tjera. Krahas menaxhimit të energjisë dhe ujit për ne është veçanërisht e rëndësishme të mbështesim zhvillimin ekonomik të vendit tuaj, edhe në sektorin e arsimit profesional. Kështu para pak kohësh bashkarisht me Zyrën Kombëtare të Punësimit kemi ngritur në Tiranë një zyrë informacioni, e cila informon rreth mundësive të punësimit dhe arsimimit në Gjermani, por edhe në Shqipëri. Shpresojmë që në këtë mënyrë t'u tregojmë rrugën e duhur para së gjithash fillestarëve në profesion, në mënyrë që ata të kërkojnë një perspektive për të ardhmen e tyre dhe të familjeve të tyre para së gjithash pikërisht këtu në Shqipëri.

Këto ditë përmbyllen me sukses javët e kulturës gjermane, që zhvillohen tanimë për herë të 10-të nën titullin „Tetori Gjerman“ në Tiranë, Shkodër Elbasan dhe Korçë duke ofruar një program të larmishëm kulturor me koncerte, filma dhe teatro, ekspozita dhe forume diskutimi të frekuentuara mjaft mirë. Edhe këtë herë ashtu si vitet e shkuara ia dolëm me sukses të ankoronim elementin e shkëmbimit në

workshop-e apo shfaqje të përbashkëta të artistëve gjermanë dhe shqiptarë. Dëshiroj të shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe njëherë të gjithë partnerët, gjermanë dhe shqiptarë, që morën pjesë në Tetorin Gjerman për bashkëpunimin shumë të mirë me ta.

Z. President,

nnë me siguri nuk kam mundur t'i përmend të gjithë ata që në 12 muajt e shkuar kanë kontribuar në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tona dypalëshe. Shumë prej tyre në fakt prej vitesh e cdo ditë kontribuojnë në kurimin e miqësisë gjermano-shqiptare.

Për të gjithë ata – gjermanë dhe shqiptarë – që angazhohen për këtë qëllim – shpreh falënderimin tim të përzemërt shoqëruar me urimin për një mbrëmje të këndshme!

Falemnderit!